

VENDIM
Nr.1310, datë 6.10.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1294, DATË 27.9.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR
TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007, PËR ÇSHTJEN “RAMADHI DHE TË
TJERË KUNDËR SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rreshtin e tretë të pikës 4 të vendimit nr.1294, datë 27.9.2008 të Këshillit të Ministrave, fjalët “...nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale,...” hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha